

Zbatimi i paradigmës së re të zhvillimit të qëndrueshëm të sipërfaqeve të përmbytura në gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për statusin e hidrosistemit “Ibër-Lepenc”

Maj 2015.

Dragisha Mijaçiq¹



Hyrje

Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit (në prill të vitit 2013) përfaqësuesit e qeverive dhe ekipeve biseduese të Serbisë dhe Kosovës bënë të ditur faktin se marrëveshja për menaxhimin e hidrosistemit “Ibër-Lepenc” nuk do të arrihet lehtë. Diskutimet aktive mbi këtë resurs të rëndësishëm strategjik vazhdojnë edhe dita ditës, përfundim ky që mund të arrihet nëse lexojmë me kujdes deklaratat e dy ekipeve negociatore. “Liqeni i Ujmanit është resurs natyror dhe pronë shtetërore e Kosovës dhe për këto tema ne nuk bisedojmë me askënd dhe në asnjë rrethanë”, kishte thënë së fundmi Edita Tahiri, kryenegociatore nga ana e Qeverisë së Kosovës.² “Nuk e jap Ujmanin” përgjigjet në anën tjetër në mënyrë energjike kryeministri serb Aleksandar Vuçiq.³ Këto dhe deklaratat tjera të shumta dëshmojnë qartë se këto negociata janë të vështira dhe se nuk ka shenja të arritjes së një zgjidhjeje optimale në të ardhmen e afërt.

Argumentet e përfaqësuesve të Serbisë ndërlihen me faktin se pjesa më e madhe e infrastrukturës së hidrosistemit “Ibër-Lepenc” gjendet në territorin e komunës së Zubin Potokut në të cilën shumicën e banorëve e përbëjnë serbët. Në territorin e së

njëjtës gjendet edhe liqeni akumulues edhe penda e “Ujmanit”, hidrocentrali si dhe akumulacioni i vogël me pendë “Pridvorica” në të cilin e ka zanafillën hidrosistemi i cili arrin deri në Prishtinë e Obiliq. Një pjesë e konsiderueshme e liqenit të Ujmanit ndodhet në territoret e komunave të Tutinit dhe Novi Pazarit. Përveç kësaj, ndërtimi i hidrosistemit “Ibër-Lepenc” është financuar me kredi të Bankës Botërore të cilën me vite të tëra e paguan Qeveria e Serbisë. Andaj, Qeveria e Beogradit konsideron se ka legjitimitet që të imponojë bisedimet mbi të ardhmen e kësaj ndërmarrjeje, duke u përpjekur që menaxhimin e saj ta vë nën Asociacionin e qyteteve dhe komunave serbe në Kosovë, e cila tek duhet të formohet në bazë të negociatave që po zhvillohen në Bruksel nën patronatin e Bashkimit Evropian.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës nuk duan të bisedojnë për të ardhmen e hidrosistemit “Ibër-Lepenc” sepse ajo është pronë e Kosovës, e sipas tyre nuk mund të vijë në konsideratë kurrfarë negociatash lidhur me pronën e Kosovës. Në këtë kuptim, Qeveria e Kosovës thirret në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nga viti 1999 me të cilën krijohet UNMIK-u, si dhe mbi Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/1 e cila përcakton se UNMIK-u merr përsipër tërë pronën e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë e cila gjendet në Kosovë; si dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 me të cilën krijohet Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e cila merr përsipër pronësinë mbi ndërmarrjet publike dhe shoqërore në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit u bart në sistemin juridik të Kosovës.

Marrë parasysh supozimin se bisedimet mbi të ardhmen e hidrosistemit “Ibër-Lepenc” megjithatë po zhvillohen në një format apo tjetrin, ky dokument përpiket që t’i kontribuojë diskutimit dhe të propozojë zgjidhje të cilat do të mund të ishin të pranueshme për të dyja palët në bisedime.

¹ *Instituti për zhvillim ekonomik territorial – InTER është themeluar në vitin 2006 si think tank jofitimprurës, i pavarur, joqeveritar, që ka për mision promovimin dhe avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm socioekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor. InTER është i regjistruar pranë Agjencisë së regjistrave ekonomike të Republikës së Serbisë dhe pranë Ministrisë së Administratës Publike të Qeverisë së përkohshme të Kosovës. Regjistrimi i dyfishtë i jep InTER status juridik dhe mundësi të funksionimit në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Për më shumë informata mbi InTER, vizitoni faqen www.regionalnirazvoj.org.*

Dragisha Mijaçiq është drejtor i Institutit për zhvillim ekonomik – InTER. Komentet dhe sugjerimet mund t’i dërgoni në adresën dmijacic@regionalnirazvoj.org.

² *Blic (22 prill 2015): <http://bit.ly/1DKHN9S>*

³ *Politika (7 maj 2015): <http://bit.ly/1EygfvQ>*

Hidrosistemi "Ibër-Lepenc"

Hidrosistemi "Ibër-Lepenc" përbën një sistem kompleks të pendave, hidrocentraleve dhe kanaleve të ujitjes i cili përbëhet nga dy njësi, pjesës veriore e cila bazohet në rrjedhat dhe potencialin e lumit Ibër dhe pjesës jugore e cila bazohet në resurset e lumit Lepenc. Pjesa veriore e hidrosistemit nënkuptonte ndërtimin e pendës dhe hidrocentralit "Ujmani", ndërtimin e pendës së vogël "Pridvorica" dhe sistemit të stacioneve të pompimit dhe kanaleve nëntokësore dhe mbitokësore të ujitjes. Ndërtimi i pjesës veriore të hidrosistemit "Ibër-Lepenc" ka filluar në vitin 1972 kur Xhemal Bjedici, atëbotë kryeministër i RSFJ-së, vendosi gurthemelin për ndërtimin e pendës së tokës në afërsi të fshatit Ujman, në bazë të së cilit kanë marrë emrin më pas edhe penda, liqeni dhe hidrocentrali. Penda e Ujmanit ka përfunduar në vitin 1977, hidrocentrali në vitin 1986, ndërsa komplet ndërtimi i pjesës veriore të hidrosistemit ka përfunduar në vitin 1986. Projekti është financuar përmes kredisë së Bankës Botërore, ndërsa punimet i ka kryer ndërmarrja "Hidrotehnika" nga Beogradit.

Pjesa jugore të hidrosistemit "Ibër-Lepenc" përbën resurs ekonomik strategjik të Kosovës. Liqeni i Ujmanit është akumulim 24km i gjatë me 380 milionë m³ ujë, një pjesë e vogël e së cilit (rreth një e treta) gjendet në territorin e komunave Tutin dhe Novi Pazar, ndërsa pjesa më e madhe e tij gjendet në territorin e komunës Zubin Potok. Penda "Ujmani" përbën një nga pendat tokësore më të mëdha në Evropë, me gjatësi prej 460m dhe me lartësi prej 107m. Nën pendë gjendet hidrocentrali me dy turbina prej 17.5kW (me kapacitet të instaluar prej 35kW) dhe liqeni kompensues "Pridvorica" me 480.000m³ ujë, nga ku fillon sistemi i kanaleve të ujitjes.

Infrastruktura e kanalit përbëhet nga kanalet e mbyllura dhe të hapura të bartjes së ujit me kapacitet 22.2m³/s dhe nga disa stacione pompimi. Kanali i ujit në gjatësi të gjithmbarshme prej 146.6km shërben për furnizim të ujit të pijes për ujësjellësit rajonalë dhe lokalë, ujitje të tokave bujqësore dhe furnizim me ujë të sistemeve të mëdha energjetike dhe stabilimenteve industriale. Përveç rrjedhës primare, kanali ndahet në tri degë të mëdha, njëra nga të cilat shkon drejt Trepçës, tjetra nga Prishtina dhe Çaglavica, nga ku uji pompohet në Badovc, dhe e treta drejt Ferronikelit dhe Glllogocit. Rrjedha kryesore shpie tek termocentrali Kosova B në Obiliq.

Hidrosistemi "Ibër-Lepenc" furnizon me ujë të pijes rreth 15% të territorit të Kosovës që gjendet në rrethet e qyteteve të Mitrovicës, Zveçanit, Skenderajt, Vushtrrisë, Glllogocit dhe Prishtinës me rrethinë (Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Graçanicë). Momentalisht është duke u punuar në ndërtimin e sistemit për furnizim me ujë të komunave të Zubin Potokut, Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit, i cili gjithashtu bazohet në ujin që vjen nga hidrosistemi "Ibër-Lepenc". Ky hidrosistem gjithashtu furnizon me ujë stabilimente të rëndësishme strategjike industriale në Kosovë, e para së gjithash këtu bëhet fjalë për "Kosovën

B"⁴ dhe "Kosovën A" dhe për Ferronikelin nga Glllogoci dhe Trepçën nga Mitrovica. Përveç kësaj, hidrosistemi "Ibër-Lepenc" ofron shërbime të ujitjes për rreth 1860 hektarë tokë bujqësore në Kosovë.⁵ Në ujin e hidrosistemit "Ibër-Lepenc" llogaritet edhe kur flitet për ftohjen e turbinave të termocentralit "Kosova e Re" me kapacitet prej 600MW, ndërtimi i së cilës parashihet gjatë viteve në vijim.

Menaxhimi i Hidrosistemit "Ibër-Lepenc"

Menaxhimi i hidrosistemit pasqyron realitetin e dualizmit që mbizotëron në veri të Kosovës. Nga njëra anë me këtë hidrosistem menaxhon ndërmarrja publike "Ibër-Lepenci" me seli në Prishtinë. Ndërmarrja "Ibër-Lepenci" është themeluar në vitin 1967 dhe në vitin 1986 është reregjistruar si ndërmarrje shoqërore për qëllime të funksionimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe pajisjeve të këtij sistemi multifunksional. Me zbarkimin e misionit të UNMIK-ut dhe themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Hidrosistemi "Ibër-Lepenc" shndërrohet në ndërmarrje publike. Në fillim të vitit 2008, hidrosistemi u bë Ndërmarrje Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh.a., në pronësi të plotë të Qeverisë së Kosovës.⁶ Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh.a. ka 196 të punësuar⁷ dhe ofron shërbime të furnizimit të ujit të pijes për ujësjellësit e disa qyteteve në Kosovë, ujit për ujitje të tokave bujqësore, ujit për stabilimente industriale (Trepça, Kosova B, Kosova A dhe Ferronikeli) dhe ujit për prodhim të energjisë elektrike.⁸

Në anën tjetër, me instalimet e hidrosistemit "Ibër-Lepenc" në veri të Kosovës menaxhon Ndërmarrja publike për furnizim të ujit dhe prodhim dhe shpërndarje të energjisë elektrike "Ibar", me seli në Zubin Potok. Këtë ndërmarrje publike e ka themeluar Qeveria e Serbisë më 15 mars 2002, por ajo kurrë nuk është njohur zyrtarisht nga organet kompetente të administratës së UNMIK-ut, andaj institucionet e Kosovës atë e konsiderojnë jolegjitime.

Me gjithë dualizmin në menaxhimin e resurseve të ndërmarrjes "Ibër-Lepenc" dhe problemet e shpeshta politike dhe të sigurisë në veri të Kosovës hidrosistemi ka funksionuar pa probleme të mëdha gjatë tërë periudhës pas vitit 1999. Kjo mund të shpjegohet me rëndësinë e madhe strategjike të këtij sistemi për stabilitetin energjetik dhe ekonomik në Kosovë.⁹

⁴ Po të ndalej uji nga hidrosistemi "Ibër-Lepenc", sipas vlerësimeve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), termocentrali Kosova B do të ishte në gjendje të funksionojë jo më shumë se gjashtë orë.

⁵ Strategjia e Kosovës për ujërat 2015-2034, f. 105.

⁶ Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" funksionon në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare (Ligji Nr. 02/L-123) dhe Ligji për ndërmarrjet publike (Ligji Nr. 03/L-087).

⁷ Përfshirë këtu edhe 21 punonjës nga Zubin Potoku

⁸ <http://bit.ly/1bOUSc3>

⁹ Përveç përfaqësuesve të autoriteteve të Prishtinës dhe Beogradit, të cilët shpesh flasin mbi rëndësinë e këtij sistemi, rëndësia strategjike e hidrosistemit "Ibër-Lepenc" theksohet

Rregullativa ligjore që ndërlidhet me Hidrosistemin "Ibër-Lepenc"

Baza juridike e funksionimit të Hidrosistemit "Ibër-Lepenc" përbëhet nga ligjet që rregullojnë sektorin e menaxhimit të ujërave dhe burimeve ujore dhe nga ligjet që rregullojnë sistemin e energjisë në Kosovë.

Bosht i rregullativës ligjore për menaxhimin e ujërave në Kosovë është Ligji për ujërat Nr. 04/L-147¹⁰ në nenin 27 të së cilit përshkruhen katër lloje të të ardhurave që realizohen me shfrytëzimin e ujërave, edhe atë për:

1. konsum nga ana e njeriut, për ujë të pijshëm dhe përgatitjen e ushqimeve, bujqësi, industri, teknologji dhe nevoja tjera;
2. prodhimin e energjisë elektrike;
3. turizëm dhe rekreacion;
4. aktivitetet e dërgimit dhe lëshimit, si dhe veprimet tjera ndaj ujit.

Kompensimi për shfrytëzimin e ujërave dhe burimeve ujore është i definuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2006, i cili përcakton lartësinë e kompensimit për të gjitha llojet e përdorimit të ujërave.

- Ujërat e patrajtuara të cilat merren drejtpërdrejt 0.001 EUR/m³;
- Ujitja e tokave bujqësore me ujë nga liqenet artificiale: 10 EUR/ha;
- Prodhuesit e energjisë elektrike duhet të paguajnë për kWh të prodhuar nga hidrocentrali: 2.5% nga çmimi i shitjes;

Është me rëndësi të theksohet se aktualisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qeveria e Kosovës janë duke kryer diskutimet publike lidhur me nxjerrjen e një Udhëzimi Administrativ mbi zonat e ngopura sanitare¹¹ i cili mes tjerash do të kufizon shfrytëzimin e potencialit ekonomik dhe turistik të liqeneve të Ujmanit, përmes ndalimit të shfrytëzimit të mjeteve lundruese me naftë, sporteve në ujë, notit, kultivimit komercial të peshkut, dhënien e ujit për kafshët, shfrytëzimit të plehrave, ndërtimit të objekteve në brigje të liqenit dhe të ngjashme. Nxjerrja e këtij udhëzimi gjithsesi do të kufizojë zhvillimin e komunave në të cilat gjendet akumulacioni, në këtë rast në komunën e Zubin Potokut.¹²

Korniza ligjore për menaxhimin dhe organizimin e sek-
edhe në raportin sekret të ambasadës amerikane në Kosovë me titullin "Sistemi i furnizimit të ujit në Kosovë: ndërvarësia e Veriut dhe Jugut bën të pamundur sabotimin." Më shumë informata në faqen: <http://bit.ly/1JhkQjn>
10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10, e datës 29 prill 2013.

11 Projektudhëzimi administrativ për zonat e mbrojtura sanitare mund të gjendet në faqen: <http://bit.ly/1cKN0y5>

12 Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ nuk do të kenë ndikim në brigjet e liqenit të Ujmanit të cilat i përkasin territorit të qytetit të Novi Pazarit dhe komunës së Tutinit.

torit të energjisë në Kosovë përbëhet nga ligjet vijuese:

- Ligjin Nr. 03/L-184 për energjinë;
- Ligjin Nr. 03/L-185 për rregullatorin e energjisë;
- Ligjin Nr. 03/L-201 për energjinë elektrike;
- Ligjin Nr. 04/L-016 për eficiencën e energjisë;

Përveç këtyre ligjeve, rol të rëndësishëm në këtë sektor luan edhe Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013-2022.

Mjetet e grumbulluara nga pagesat për shfrytëzim të ujërave apo prodhim të energjisë elektrike paguhen në buxhetin e Kosovës. Përkundër faktit se pjesa më e madhe infrastrukturës së hidrosistemit "Ibër-Lepenc" gjendet në komunën e Zubin Potokut, e cila ka si e tillë ka pësuar dëme të mëdha nga ndërtimi i akumulacionit të ujit "Ujmani";¹³ deri tani nuk është krijuar kurrfarë mekanizmi me të cilin do ta kompensonte humbjen e tokës së përmblytur dhe i cili do të mundësonte zhvillim të qëndrueshëm të këtij regjioni.¹⁴ Me fjalë tjera, legjislacioni kosovar nuk parasheh kurrfarë kompensimi për komunat në territorin e të cilave ndodhen akumulacionet e ujit për ujitje apo prodhim të energjisë elektrike.

Paradigma e re e zhvillimit të sipërfaqeve në të cilat ndodhet hidrosistemi

Gjatë viteve të 90ta, Banka Botërore e ka pasur në konsideratë faktin se ndërtimi dhe mirëmbajtja e hidrosistemit mund t'i kontribuojnë në masë të theksuar zvogëlimin të varfërisë në vendet në zhvillim. Analizat kanë treguar se ndërtimi i hidrosistemit më së shumti prekë banorët lokalë të cilët bartin pasojat e zhvendosjes së detyruar dhe ndryshimit të rrethanave shoqërore dhe ekonomike, përfshirë këtu humbjen e të hyrave, humbjen e vendeve të punës, humbjen e pronave, infrastrukturës sociale e të ngjashme. Kompensimi i njëhershëm për përmblytjen e tokave nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar humbjet të cilat i pësojnë banorët lokalë. Andaj, Banka Botërore ka filluar me zbatimin e një paradigme të re e cila parasheh ndarjen më të drejtë të fitimeve (ndarja e përfitimeve) nga shfrytëzimi i hidrosistemit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e zhvillimit të komuniteteve lokale që preken nga ndërtimi i instalimeve të tilla.¹⁵¹⁶ Ndarja e

13 Me ndërtimin e liqenit të Ujmanit vetëm në komunën e Zubin Potokut janë përmblytur 13 fshatra dhe janë zhvendosur rreth 3.500 banorë, shumica prej së cilëve janë larguar përherë nga kjo komunë.

14 Kësisoj, për shembull, investimi i gjithmbarshëm i Ministrisë së ekonomisë (dhe financave) të Qeverisë së Kosovës në komunën e Zubin Potokut për periudhën 2006-2011 ka qenë 14.820€ apo 2€ për kokë banori. Burimi: Strategjia për ujërat e Kosovës 2015-2034, f. 132.

15 Chaogang Wang, A Guide for Local Benefit Sharing in Hydropower Projects, Social Development Working Papers No. 128/qershor 2012, Banka Botërore, mund të gjendet në <http://bit.ly/1dE9Fay>

16 Leif Lillehammer, Orlando San Martin dhe Scivcharn Dhillion, Benefit Sharing and Hydropower: Enhancing Development Benefits of Hydropower Investments Through an

përfitimeve njihet edhe nga komisioni botëror i pendave¹⁷ i cili në raportin e tij nga nëntori i vitit 2000 ndarjen më të drejtë të fitimeve e vendosë si një nga shtatë prioritetet e avancimit të menaxhimit të hidrosistemeve.¹⁸

Ndarja e përfitimeve merr si shembull instrumentet e ndryshme financiare dhe jofinanciare të cilët janë të bazuar në marrëveshje mes të gjithë akterëve kyçë: ndërmarrjet për menaxhim të hidrosistemeve, përfaqësuesit e autoriteteve në nivele të ndryshme dhe përfaqësuesit e komuniteteve lokale (përfshirë organizatat joqeveritare).

Instrumentet financiare nënkuptojnë ndarjen e një pjese të caktuar të fitimeve të realizuara nga shfrytëzimi i hidrosistemit për nevoja të zhvillimit të komuniteteve lokale dhe përfshirjen e mekanizmeve të transferimit të drejtpërdrejtë të tyre në buxhete të autoriteteve lokale apo rajonale, si dhe më pas mundësinë e dhënies së prioritetit në furnizim me energji elektrike apo ujë, çmime më të volitshme të energjisë elektrike apo ujit nga hidrosistemi, financimin e projekteve për mbrojtje të ambientit dhe shoqatave ekologjike, formimin e fondit për zhvillim të komunitetit apo ndarjen e aksioneve të ndërmarrjes që e menaxhon hidrosistemin. Në anën tjetër instrumentet jofinanciare nënkuptojnë bashkëpunim me komunitetin lokal gjatë hartimit të dokumentacionit të projekteve apo gjatë menaxhimit të hidrosistemit, me qëllim të realizimit të përfitimeve maksimale për popullatën lokale. Instrumentet jofinanciare gjithashtu nënkuptojnë përfitimet nga infrastruktura sekondare e cila ndërtohet për nevoja të hidrosistemit (rrugët, kapacitetet e vendosjes për punëtorë, infrastruktura sportive, etj.) si dhe mundësitë e punësimit të popullatës lokale.

Roli i qeverisë qendrore gjithashtu është tejet i rëndësishëm për identifikimin e nevojave në mënyrë që hapësirat në të cilat ndërtohen hidrosistemet e mëdha

Operational Framework, Final Synthesis Report, Raport i Sweco për Bankën Botërore, shtator 2011.

17 Komisioni Botëror i Pendave (World Commission of Dams) është themeluar në maj të vitit 1998 me ndërmjetësim të Bankës Botërore dhe Unionit Botëror për Konservim (UICN), si përgjigje ndaj kundërthënive vendore dhe ndërkombëtare lidhur me ndërtimin e pendave të mëdha. Është në mandatin e kësaj organizate që të vlerësojë ndikimin zhvillimor të ndërtimit të pendave të mëdha si dhe alternativave të mundshme për burimet ujore dhe zhvillimin e energjetikës; si dhe të zhvillojë kritere ndërkombëtarisht të pranueshme, udhëzues dhe standarde për planifikim, projektim, ndërtim, vlerësim të ndikimit përcjellje të punëve dhe ndalim të shfrytëzimit të pendave. Më shumë mbi komisionin ndërkombëtar për pendat mund të gjeni në faqen: <http://bit.ly/1ClpTXI>

18 Dams and Development: A New Framework for Decision-Making, the World Commission of Dams, nëntor 2000, <http://bit.ly/1zZPu0E>

të trajtohen në mënyrë të posaçme me qëllim që të mundësohet zhvillimi i qëndrueshëm shoqëror-ekonomik i tyre dhe të zvogëlohen eksternalitetet negative. Në këtë drejtim, autoritetet qendrore nxjerrin ligje, akte nënligjore dhe politika të cilat stimulojnë zhvillimin e këtyre hapësirave.

Ekzistojnë edhe shumë shembuj tjerë të zbatimit të kësaj paradigme të re të ndarjes së barabartë të përfitimeve me të cilën stimulohet zhvillimi socioekonomik i regjioneve në të cilët ndërtohen hidrosistemet, disa prej të cilëve do t'i paraqesim në vijim.

Norvegjia

Parimi i ndarjes së përfitimeve me rastin e ndërtimit dhe menaxhimit të hidrosistemeve në Norvegji rregullohet me ligje të ndryshme, mes të cilëve më të rëndësishmit janë: Ligji për koncesione industriale nr. 16 (1917), Ligji për rregullimin e rrjedhave të ujit (1917), Ligji për energjinë (1991) dhe Ligji për resurset ujore (2000).

Për shkak të relievit specifik me rastin e ndërtimit të hidrocentraleve në Norvegji nuk kryhen shumë zhvendosje të detyruara të popullatës. Megjithatë, komunat në të cilat ndodhen hidrosistemet kanë përfitime të theksuara nga këto instalime, si në vijim:

- Tatimet dhe taksat të cilat ndërmarrjet e hidrosistemeve u paguajnë autoriteteve rajonale dhe lokale. Mes tyre janë edhe taksa për shfrytëzim të resurseve, tatimi në fitim i ndërmarrjes së hidrosistemit dhe pagesat për leje të punës. Taksa për shfrytëzimin e resurseve kalkulohet në bazë të prodhimit mesatar të energjisë elektrike nga hidrosistemi;
 - Tatimi në fitim: 28%, nga të cilat 20.75% shkojnë në buxhetin qendror, 2.5% tek autoritetet rajonale dhe 4.75% tek autoritetet lokale;
 - Tatimi në pronë: 0.7% nga vlera e hidrosistemit në treg;
 - Taksa për resurse: 0,013 NOK (0,0015 EUR) për kilovat-orë të prodhuar në pragun e centralit, nga të cilat 0,011 NOK (0,0013 EUR) u shkon komunave ndërsa 0,002 NOK (0,0002 EUR) autoriteteve rajonale;
 - Taksat: hidrosistemet obligohen që komunave t'ua sigurojnë 10% të energjisë elektrike të cilën e prodhojnë në territorin e tyre.
- Aksionet në ndërmarrje: komunat janë bashkëpronare të hidrosistemeve dhe marrin dividenda;
- Çmimet më të volitshme të rrymës: komunat në të cilat gjenden hidrosistemet kanë çmim më të volitshëm për rrymën që prodhohet në territorin e tyre;
- Fondi për zhvillim lokal: ndërmarrjet e hidrosistemeve paguajnë mjete të pakthyeshme në Fondin për zhvillim lokal me të cilin menaxhojnë komunat në territorin e së cilave gjenden sistemet në fjalë.

Mali i Zi

Edhe Mali i Zi ka rregullativë ligjore stimuluese e cila mundëson zhvillim të komunave në territorin e së cilave gjenden sistemet hidroakumuluese. Këtë sferë e rregullon Ligji për financimin e menaxhimit të ujërave¹⁹ që parasheh pagesën e kompensimit për shfrytëzim të ujërave për prodhim të energjisë elektrike, qëllime tjera industriale, ujitje, komunal, etj. Me këtë ligj parashihet edhe ndarja e mjeteve të grumbulluara nga autoritetet qendrore dhe komunat në territoret e së cilave ndodhen resurset ujore, në proporcionin 70:30.

Pagesat bëhen për shfrytëzimin e fuqisë së ujit për vënie në funksion të stabilimenteve prodhuese, në bazë të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar (kWh) në pragun e centralit. Në rrjedha ujore ndërshtetërore, pagesa bëhet sipas sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga uji me të cilin mbushet hidroakumulacioni në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ujërat e territorit të Malit të Zi, përveç në rastet kur kjo çështje është e rregulluar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare. Pagesa kryhet edhe për shfrytëzim të ujërave në kushte jashtëzakonisht të volitshme përmes shfrytëzimit të hidroakumulacioneve, ndërsa realizohet kundrejt vëllimit (m³) të hidroakumulacionit apo një pjese të tij që përcaktohet me dokumentacionin teknik.

Lartësia e pagesës për shfrytëzim të ujërave është e caktuar me vendim të posaçëm të Qeverisë së Malit të Zi.²⁰ Këtu do të shfaqet vetëm lartësia e pagesave për shfrytëzim të ujërave që janë relevante për këtë dokument:

- Pagesa për ujë të pijes dhe për nevoja komunale 0,015 EUR/m³ ujë të furnizuar ;
- Pagesa për nevoja industriale dhe teknologjike 0,02 EUR/m³ ujë të shfrytëzuar;
- Pagesa për ujitje 0,004 EUR/m³ ujë të zënë;
- Pagesa për marrje dhe sjellje të ujit për qëllime komerciale 0,03 EUR/m³ ujë të furnizuar;
- Pagesa për prodhim të energjisë në prag të energjisë elektrike 0,0001 EUR/kWh, për shfrytëzim të ujërave në rrethana jashtëzakonisht të volitshme, përmes shfrytëzimit të hidroakumulacionit 0,0006 EUR/m³, ndërsa për qëllime tjera industriale 0,00005 EUR/kW.

Bosnjë dhe Hercegovina

Të dy entitetet e Bosnjës dhe Hercegovinës kanë legjislacion të volitshëm që stimulon zhvillimin në komunat në të cilat ndodhen objektet hidroakumuluese.

Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës këtë sferë e rregullon Ligji për ndarjen dhe drejtimin e një pjese të të hyrave të realizuara nga shfrytëzimi i objekteve hi-

¹⁹ Gazeta Zyrtare e MZ, Nr. 65/08

²⁰ Vendimi mbi lartësinë dhe mënyrën e kalkulimit të taksave për ujë dhe kriteret dhe mënyrën e përcaktimit të nivelit të ndotjes së ujërave, Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 29/09, e datës 24 prill 2009.

droakumuluese²¹ i cili përcakton kompensim prej 0,01 KM (0,0051EUR) për kWh të prodhuar dhe 0,005KM (0,0025EUR) për m³ të shpenzuar. Pagesa harmonizohet me ngritjen apo zbritjen e çmimit të energjisë elektrike të cilin e cakton komisioni rregullativ për energji elektrike i Federatës së BeH.

Pagesa bëhet në buxhet të komunës apo qytetit në territorin e së cilit është ndërtuar objekti hidroakumulues. Nëse hidroakumulimi është ndërtuar në territor të dy apo më shumë komunave, mjetet ndahen proporcionalisht me sipërfaqen e përmbytur dhe sasinë e ujit të grumbulluar nga komunat përkatëse.

Rregullativë e ngjashme ligjore ekziston edhe në entitetin tjetër të Bosnjë dhe Hercegovinës - në Republikën Serbe. Kjo sferë rregullohet me Ligjet për kompensimet e shfrytëzimit të resurseve natyrore me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike²² që parasheh kompensim prej 0.01KM (0.0051 EUR) për kWh të prodhuar. Mjetet paguhen në buxhetet e komunave në territoret e së cilave gjenden objektet e hidroakumulacionit dhe në Fond të Solidaritetit për ripërtëritje të Republikës Serbe, sipas proporcionit 50:50.²³ Nëse objektet hidroakumuluese janë të ndërtuara në territorin e më shumë se një komune, pagesa ndahet proporcionalisht me sipërfaqen e tokës së përmbytur.

Zgjidhjet ligjore në Republikën Serbe parashohin që komunat të mund t'i shfrytëzojnë mjetet e grumbulluara nga shfrytëzimi i ujit për prodhim industrial të energjisë elektrike për qëllimet në vijim:

- Ndërtimin dhe sanimin e objekteve të infrastrukturës primare (ujësjellësi, kanalizimi, gypat e nxehjes, rrugët lokale, etj.), që i shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe punësimit.²⁴
- Ndërtimin e kapaciteteve të reja ekonomike apo zgjerimin e atyre ekzistuese, përfshirë kreditimin stimulues, si dhe qëllimet tjera të përcaktuara me programin e shfrytëzimit të mjeteve të paguara në bazë të tarifave, të cilat komunat janë të detyruara t'i miratojnë në kuvendet lokale dhe t'ia paraqesin Ministrisë së Financave të Republikës Serbe.

Zbatimi i paradigmes së re si pjesë e zgjidhjes së qëndrueshme të problemit të menaxhimit të hidrosistemit "Ibër-Lepenc"

Ndërtimi i hidrosistemit "Ibër-Lepenc" nuk i ka kontribuar

²¹ Gazeta Zyrtare e FBeH, Nr. 44, e datës 12 shtator 2002, 18/3, 9/04, 57/06

²² Gazeta Zyrtare e Republikës Serbe, Nr. 52, e datës 16 qershor 2014.

²³ Ndarja e mjeteve është vendosur me Ligjin e vitit 2014, me të cilin edhe formohet fondi i solidaritetit me të cilin do tu ndihmohej zonave të përmbytura. Me rregullimin praktik ligjor të gjitha mjetet e grumbulluara në bazë të kësaj u shkonin komunave.

²⁴ Për zhvillim të infrastrukturës duhet të përdoren së paku 30% të të gjitha mjeteve të cilat janë grumbulluar sipas këtij ligji.

zhvillimit të qëndrueshëm të komunave në territorin e të cilave gjenden instalimet kryesore infrastrukturore të këtij sistemi. Në fakt, me ndërtimin e akumulacionit "Ujmani" komuna e Zubin Potokut dhe pjesë të komunave të Tutinit dhe Novi Pazarit e kanë humbur bazën demografike dhe ekonomike, gjë që i ka kontribuar stagnimit të zhvillimit të tyre. Prandaj, nuk befason fakti se këto komuna janë mes komunave më të pazhvilluara në Ballkan.

Legjislacioni ekzistues në Kosovë dhe Serbi nuk stimulon zhvillimin e komunave në të cilat gjenden akumulacionet për prodhim të energjisë elektrike apo për qëllime të ujitjes, ndërsa të hyrat e realizuara përmes eksploatimit të këtyre resurseve derdhen në ndërmarjet që menaxhojnë me këto resurse apo në buxhetin qendror. Marrë parasysh se e ardhmja e Hidrosistemit "Ibër-Lepenc" është në fokus të negociatave mes Prishtinës dhe Beogradit, kjo përbën një mundësi unike që të vihen në vend padrejtësitë të cilat i bëhen komunave të Zubin Potokut, Tutinit dhe Novi Pazarit, si dhe komunave tjera në Kosovë mbi territoret e së cilave ndodhet rrjeti i kanalit, duke u ndihmuar kështu në një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Këtij qëllimi i shërbejnë edhe rekomandimet në vijim të cilat do t'i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm të sipërfaqeve të përmbytura.

Rekomandimi 1: Të zbatohet paradigma e re e ndarjes së drejtë të fitimit si përkrahje për komunat e dëmtuara nga ndërtimi i Hidrosistemit "Ibër-Lepenc"

Marrë parasysh se të hyrat nga shfrytëzimi i resurseve të Hidrosistemit "Ibër-Lepenc" i merr ekskluzivisht Kosova, është me rëndësi që të miratohen ligje dhe akte nënligjore nën kornizën juridike të Kosovës, me të cilat do të garantohej ndarje e barabartë e një pjese të fitimit të realizuar, në pajtim me parimet e praktikave të mira, duke e zbatuar në praktikë këtë paradigmë të re të zhvillimit të komunave që janë dëmtuar nga ndërtimi i sistemit në fjalë. Kjo rregullativë ligjore do duhej të rregullonte bartjen e një pjese të të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i resurseve të këtij sistemi tek komunat në të cilat gjenden pjesë të Hidrosistemit "Ibër-Lepenc", të realizuara përmes pagesës së tarifave për shfrytëzimin e ujit për prodhim të energjisë elektrike, ujitje, komunalit dhe industri. Në këtë kuptim, rekomandohen zgjidhjet në vijim:

- Gjysma e të hyrave nga tarifat për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralin "Ujmani" duhet të ndahet mes komunave Zubin Potok, Tutin dhe Novi Pazar, proporcionalisht me sipërfaqen e tokës së përmbytur dhe sasinë e ujit të grumbulluar nga territori i këtyre komunave. Kjo pagesë matet në bazë të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar (në kW) në pragun e centralit dhe në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar

(në m³). Gjysma tjetër e kësaj pagese duhet të ndahet mes buxhetit të Kosovës dhe buxhetit të Bashkësisë së komunave serbe në Kosovë, sipas përqindjes për të cilën do të arrihet marrëveshja gjatë bisedimeve në Bruksel. Lartësia e pagesës duhet të harmonizohet me çmimin e energjisë elektrike në Kosovë.

- Së paku dy të tretat e të ardhurave nga pagesat për shfrytëzim të ujërave nga akumulacioni për nevoja të ujitjes, komunalit apo nevoja industriale duhet të ndahen mes komunave Zubin Potok, Tutin, Novi Pazar dhe komunave tjera në Kosovë (Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Glogoc) në të cilat gjendet rrjeti i kanaleve të Hidrosistemit "Ibër-Lepenc", proporcionalisht me sipërfaqen e përmbytur për qëllim të ndërtimit të tij. Kjo pagesë matet në bazë të ujit të furnizuar (në m³) në pragun e pendës "Pridvorica". Një e treta e kësaj pagese do të ndahet mes buxhetit të Kosovës dhe buxhetit të Bashkësisë së komunave serbe në Kosovë sipas përqindjes që do të përcaktohet në bisedime në Bruksel. Lartësia e pagesës duhet të harmonizohet me rregulloren e pagesave të ujit për ujitje, komunalit, ftohje të turbinave të termocentraleve apo për nevoja industriale.
- Autoritetet lokale në Kosovë dhe Serbi të cilat kanë të hyra nga pagesat për shfrytëzimin e ujit nga akumulacioni "Ujmani" mund të shfrytëzojnë këto mjete ekskluzivisht për realizimin e programeve zhvillimore dhe projekteve që janë në pajtueshmëri me strategjitë zhvillimore të autoriteteve lokale përkatëse. Së paku gjysma e të hyrave në komunat Zubin Potok dhe Tutin duhet të shfrytëzohen për zhvillim të fshatrave dhe vendbanimeve të cilat kanë pësuar dëm të drejtpërdrejtë nga përmbytja e liqenit, ndërsa në rastin e qytetit të Novi Pazarit, përqindja e përfitimeve të drejtpërdrejta të fshatrave që kanë pësuar dëme nga ndërtimi i akumulacionit "Ujmani" nuk guxon të jetë nën 75%.
- Duhet të themelohet një Agjenci rajonale për zhvillim të qëndrueshëm të liqenit të Ujmanit, e cila do të kishte ingerenca mbi tërë territorin e akumulacionit (në fshatrat dhe vendbanimet e komunave Zubin Potok, Tutin dhe Novi Pazar). Në lidhje me këtë, duhet të gjendet mekanizmi juridik përkatës për themelimin dhe veprimtari të një agjencie të tillë në territorin e Kosovës dhe Serbisë. Agjencia do të merrej me promovimin e turizmit, zhvillimit ekonomik dhe rural, ndërsa do të kishte autorizime ekzekutive në ruajtjen e mjedisit dhe rregullimin e peshkimit në liqenin e Ujmanit. Agjencia rajonale do të financohej nga mjeet të cilat u janë ndarë komunave nga pagesat për shfrytëzimin e ujit nga akumulacioni "Ujmani", mjetet e transferuara nga niveli qendror i qeverisë në Prishtinë dhe Beograd, nga programet e BE-së dhe nga donacionet.

Rekomandimi 2: Të ruhet stabiliteti energjetik i komunave në veri të Kosovës

Hidrocentrali "Ujmani" luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit energjetik të komunave në veri të Kosovës, në veçanti të komunave Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicës së Veriut. Andaj, është e domosdoshme që të mbahen mekanizmat për furnizimin e energjisë elektrike që prodhohet në hidrocentralin "Ujmani" tek konsumatorët nga këto komuna të veriut të Kosovës. Një pjesë e energjisë elektrike nga centralet duhet të furnizohet në sistemin elektroenergjetik të Kosovës për ta ruajtur stabilitetin e tij.

Rekomandimi 3: Liqeni i Ujmanit të trajtohet si resurs ekonomik, bujqësor dhe turistik

Hidroakumulacioni "Ujmani" përbën resurs ekonomik, bujqësor dhe turistik i cili duhet të shfrytëzohet në mënyrën më të mirë të mundshme për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të komunave të Zubin Potokut, Tutinit dhe Novi Pazarit. Prandaj duhet të nxirren akte ligjore në Kosovë dhe Serbi me të cilat stimulohet shfrytëzimi optimal i potencialit të liqenit të Ujmanit, duke marrë parasysh praktikatat moderne të mbrojtjes së mjedisit në rast të kapzhave dhe akumulacioneve. Zgjidhjet që propozohen në projektudhëzimin administrativ të ri të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Qeverisë së Kosovës kufizojnë zhvillimin e hapësirës rreth liqenit të Ujmanit, prandaj do duhej të organizohen debate publike më të gjera për të diskutuar mbi përparësitë dhe mangësitë e propozimeve në fjalë.

Këtu duhet të theksohet domosdoshmëria e zgjidhjeve së problemit të hedhjes dhe pastrimit të mbeturinave komunale të cilat përfundojnë në liqenin e Ujmanit. Në këtë kuptim më së shumti probleme shkakton deponia e qytetit të komunës së Rozhajës në Mal të Zi, e cila është e vendosur në brigje të lumit Ibër, në pjesën që më pas rrjedh në liqenin e Ujmanit, nga e cila vijnë më së shumti mbeturina komunale. Sipas kësaj, në zgjidhjen e problemeve të ndotjes së liqenit të Ujmanit duhet të përfshihen edhe autoritetet lokale dhe qendrore nga Mali i Zi sepse ky problem tejkalon kornizat e bisedimeve mes Beogradit dhe Prishtinës.

Rekomandimi 4: të negociohet mbi zgjidhjen përfundimtare për Ndërmarrjen Publike Ibër-Lepenc

Hapi i parë në zgjidhjen e statusit të ndërmarrjes publike "Ibër-Lepenc" duhet të jetë ndryshimi i strukturës së pronësisë mes autoriteteve qendrore në Kosovë dhe autoriteteve lokale në të cilat gjenden instalimet e kësaj ndërmarrjeje, edhe atë në proporcion 50:50. Autoritetet lokale do të merrnin pjesë në strukturën pronësore proporcionalisht me sipërfaqen që e mbulojnë objektet infrastrukturorë me të cilat disponon "Ibër-Lepenci" (akumulacionet e ujit, hidrocentrali dhe rrjeti i kanaleve dhe stacioneve të pompimit). Në ndarjen e pronësisë duhet të përfshihen edhe autoritetet vetëqeverisëse lokale të Tutinit dhe Novi Pazarit të cilat funksionojnë nën sistemin juridik të Serbisë.


Zgjidhja përfundimtare për ndërmarrjen publike "Ibër-Lepenc" duhet të kërkohet në privatizimin apo kapitalizimin e mëtejshëm të saj. Marrë parasysh rëndësinë strategjike të resurseve me të cilat disponon kjo ndërmarrje, është me rëndësi që ajo së paku pjesërisht të mbetet pronë publike, prandaj nuk propozohet privatizimi i plotë i saj. Megjithatë, kjo ndërmarrje duhet të kapitalizohet më tej në mënyrë që të avancohet efikasiteti i saj në menaxhim të këtij sistemi dhe në mënyrë që të sigurohen mjetet për ripërtëritje të infrastrukturës, para së gjithash të infrastrukturës së rrjetit të kanaleve e cila është në gjendje relativisht të keqe.

Kontesti mbi pronësinë mes Serbisë dhe Kosovës dhe kompensimi eventual i Kosovës për Serbinë për shpërgimim e kredisë së Bankës Botërore me të cilën është ndërtuar sistemi "Ibër-Lepenc" duhet të zgjidhen brenda kornizës së negociatave në Bruksel.

Rekomandimi 5: të aplikohet paradigma e re e ndarjes së përfitimeve edhe për vendet tjera në territorin e të cilave ndodhen sistemet hidroakumuluese

Rasti i hidrosistemit "Ibër-Lepenc" nuk duhet të trajtohet si rast sui generis, ndërsa qeverive të Kosovës dhe Serbisë iu rekomandohet që të miratojnë rregullativën e domosdoshme ligjore që do të mundësonte aplikimin e paradigmes së re edhe në sipërfaqe tjera të përmytura, me qëllim të sigurimit të kushteve adekuate për zhvillim socioekonomik të tyre. ■

HARTA SKEMATIKE SISTEMI I UJITJES IBËR-LEPENC



Dalja e tunelit në Koshtovë

ON Verbnicë

Dalja e tunelit në Bukosh

ON Mihaliq

ON Hamidi

SPU - Stacionet Pompike të Ujitjes
 SPD - Stacionet Pompike të Drenazhimit
 SPK - Stacionet Pompike Kryesore
 ON - Objektet Ndarëse

SPU

1. Çagllavicë
2. Samadrazhë
3. Banjska
4. Pantina
5. Medunak
6. Zubin Potok
7. Fushticë
8. Gjurashin
9. Koraticë
10. Krashticë

SPD

1. Prilluzhë
2. Barnovci

ON

1. Verbnicë
2. Mihaliq
3. Hamidi
4. Vasilevë

SPK

1. Besi
2. Bivolak
3. Çagllavicë

Legjenda:

- Qytetet
- Kanali Kryesor
- Lumenjt
- Rrugët
- Zona e ujitjes
- Stacionet Pompike Kryesore
- Stacionet Pompike për Ujitje
- Objektet Ndarëse

